



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	27.02.2024
REFERENC-Ë:	23/2580/MMPHI
PËR/ZA/TO:	N.T.P. "Abi & Elif 19" Prizren Fabrike për prodhimin, konzervimin e frutave, perimeve si dhe prodhimin e keqchapit dhe mërmeladës
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit N.T.P. "Abi & Elif 19" Prizren, me Nr. Prot. 23/2580/MMPHI dhe ka vendosur si ne Vendim për Leje Mjedisore te bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/2580/MMPHI  
Datë: 27.02.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori N.T.P. "Abi & Elif 19" Prizren, pajiset me Leje Mjedisore për fabrikën e prodhimit, konservimit të frutave, perimeve si dhe prodhimin e kechapit dhe marmelatës, në ngastrën kadastrale nr. 06939-0, zona kadastrale Prizren.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Vlerat e cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.3. Raportin e emisioneve në ajr sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPHI-së;
- 2.4. Vlerat e nivelit të zhurmës të jene në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.5. Të respektohen kushtet e përcaktuara me Lejet Ujore për shfrytëzim dhe shkakim të ujit;

Faqe 2 nga 4



- 2.6. Te avancohet impianti i trajtimit te ujerave qe shkarkohen nga procesi i prodhimit teknologjik sipas praktikave me te mira te mundshme sipas legjislacionit ne fuqi;
- 2.7. Te avancohet sistemi për depluhurimin e gazrave shkarkuese;
- 2.8. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- 2.9. Për sistemin menaxhues mjedisore të ketë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
- 2.10. Për zgjerim te kapacitetit dhe ndryshim të veprimtarisë, operatori obligohet të njoftoje MMPHI- ne;
- 2.11. Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit te këtij vendimi.

### A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin N.T.P. "Abi & Elif 19" Prizren, për fabrikën e prodhimit, konservimit te frutave, perimeve si dhe prodhimin e ketchupit dhe marmelatës, në ngastrën kadastrale nr. 06939-0, zona kadastrale Prizren

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 20/7220/1-ZSP/182/23 të lëshuar me dt. 25.04.2023;
- Komuna Prizren- Informim me nr. 04-353/01-161426, te lëshuar me dt. 16.11.2022;
- Leje Ujore- për Shfrytëzim te ujit me Nr. 7222/22-ZSP-2023, te lëshuar me dt. 28.02.2023;
- Leje Ujore- për Shkarkim te ujit me Nr. 7225/22-ZSP-2023, te lëshuar me dt. 28.02.2023;
- Kontrate mbi ofrimin e shërbimeve ne grumbullimin e mbeturinave me K.R.M.



Andaj bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar dhe plotësuar nga pala dhe gjendjes faktike, duke përfshi shikimin ne vend nga zyrtarët profesional sipas legjislacionit ne fuqi për mjedisin, dhe Udhëzimit Administrativ te MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si ne diapozitiv.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore ne diapozitiv është përcaktuar, në përputhje nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Životnu Sredinu i Vodu /*  
*Department of Environment Protection and Water*

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

<b>REFERENC-Ë:</b>	23/2580/236/ MMPHI-DMMU				
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI				
<b>CC:</b>	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së				
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Abdullah Pirçe, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU 				
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Komisioni për Leje Mjedisore				
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Përgjigje ne kërkesën e operatorit N.T.P. "Abi & Elif 19" Prizren Fabrike për prodhimin, konzervimin e frutave, perimeve si dhe prodhimin e ketchupit dhe mërmeladës				
<b>Nr. i zyrës:</b>	1517	<b>Lokacioni:</b>	Ish pallati i mediave	<b>Data:</b>	27.02.
<b>Br. kancelarije:</b>		<b>Kucni:</b>	Rilindja, Prishtinë.	<b>Datum:</b>	2024
<b>Room No.:</b>		<b>Extension:</b>		<b>Date:</b>	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input checked="" type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
<b>AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE</b>					

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 7416/23, të dt. 22.12.2023, duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L- 025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neni 9 i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori N.T.P. "Abi & Elif 19" Prizren, ka aplikuar me Nr. Prot. 23/2580/236/MMPHI-DMMU për tu pajisur me Leje Mjedisore, për fabrikën e prodhimit, konservimit të frutave, perimeve si dhe prodhimit të ketchupit dhe marmelatës, në ngastrën kadastrale nr. 06939-0, zona kadastrale Prizren, sipas Pëlqimit Mjedisor me Nr. 22/7220/1-ZSP/182/23 të lëshuar me dt. 25.04.2023.

Komisioni për Leje Mjedisore ka realizuar vizite te operatori, për verifikimin e gjendjes ne vende tek operatori me dt. 10.08.2023.

Gjate vizitës ne teren është bërë verifikimi i procesit teknologjik në fazat në të cilat bëhet konservimi i frutave, perimeve si dhe prodhimit të ketchupit dhe marmelatës. Faza e klasifikimit dhe shpëlarjes me ujë në pajisjen adekuate të frutave dhe perimeve, faza e mbushjes me fruta në kavanoza, faza e sterilizimit që zhvillohet në temperaturë me të madhe se 90 °C dhe faza e paketimit të prodhimit të produkteve të gatshme. Për nevojat e procesit të prodhimit shfrytëzohet nxehtësia nga kaldaja e përbashkët për të tri veprimtaritë. Po ashtu është verifikuar edhe kaldaja e cila funksionon me thëngjill me këta parametra: T=250 °C dhe P=8 bar. Kaldaja është e përberë me pajisjen përcjellëse depluhuruese dhe oxhakun për shkarkimin e gazrave nga procesi i djegies së thëngjillit në dhomën e djegies së kaldajës në standarde të emetimit. Shkarkimi i ujit bëhet në sedimentuesin e përbashkët për të tre veprimtaritë. Behet ndarja e yndyrave dhe vajrave në sedimentues të cilat tërhiqen me kamion cisterne nga kontraktori me kompaninë.

Palës iu është bërë e ditur që duhet të monitoroj në vazhdimësi emisionet në ajër sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e ajrit, për të cilat i paraqiten obligative dhe në Lejen Mjedisore.

Komisioni, pas realizimit të vizitës në teren ka kërkuar nga operatori, plotësim të dokumentacionit dhe kushteve të cekura më poshtë:




- Plotësime i pjesës tjetër te tarifës ne përputhje me vendimin e tarifave Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022;
- Raporti i Emisioneve ne ajër tek oxhaku i kaldajës;
- Raporti i Pluhurit tek oxhaku i kaldajës;
- Raporti i zhurmës;
- Kontrate me Kompaninë e Mbeturinave.

Operatori, për kushtet e cekura me lartë ka sjell informata shtesë për plotësim te kushteve duke prezantuar edhe foto dëshmi për rregullimin e gjendjes ne terren sipas kërkesës te komisionit për Leje Mjedisore.

Komisioni, pas grumbullimit të gjetjeve në teren dhe kontrollimin e pranimit të dokumenteve shtese me date: 18.01.2024, në përbërje prej tre (3) anëtareve, unanimitisht ka ardhur ne përfundim që operatori mund te vazhdoj veprimtarinë duke iu përmbajtur kriterëve te përcaktuara ne këtë vendim për Leje Mjedisore sipas legjislacionit ne fuqi.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjeni edhe propozim vendimin për Leje Mjedisore.

Komisioni:

Fatlije Buza, kryesuese	
Adem Tusha, anëtar	_____
Përparim Terziu, anëtar	
Fatmir Bytyqi, anëtar	
Mentor Shala, anëtar	<i>Nuk ka qene prezent ne takim.</i>



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	DEMMU
Nr. i Faqesve Dr. Stranica No. Pages	1
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	2579-2/23
Data: Datum: Date:	28.02.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters*

REFERENC-Ë:	23/2580/236/MMPHI-DMMU
DATË/A:	27.02.2024
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Abdullah Pirçe, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU
NGA/OD/FROM:	Fatlje Buza, kryesuese e komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin N.T.P. "Abi & Elif 19" Prizren Fabrike për prodhimin, konzervimin e frutave, perimeve si dhe prodhimin e ketchupit dhe mërmeladës

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokoli: 23/2580/236/MMPHI-DMMU, të operatorit N.T.P. "Abi & Elif 19" Prizren, për fabrikën e prodhimit, konservimit të frutave, perimeve si dhe prodhimin e ketchupit dhe marmelatës.

Me respekt,